



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 51/2019 (JR)  
Nr. 51/... regj.

Tiranë, më 25.06.2020

SHPALLJE  
E

**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË GJYQËSORE PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se seanca gjyqësore publike për vazhdimin e gjykimit të çështjes së Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 51/2019 (JR), datë 17.10.2019, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 169, datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Regleta Panajoti, do të zhvillohet **ditën e premte, në datën 10.07.2020, ora 10.00.**

Seanca gjyqësore e datës 25.06.2020 u vendos të ndërpritet me qëllim marrjen e konfirmimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të faktit të depozitimit nga subjekti i rivlerësimit Regleta Panajoti të kërkesës për dorëheqje nga statusi i magjistratit, si dhe nëse kjo kërkesë është shoqëruar prej saj me ndonjë kërkesë të motivuar për përsheptimin e efekteve të dorëheqjes, në kuptim të parashikimeve të nenit 65, paragrafi 3 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit të dëgjohet personalisht nga trupi gjykues, në lidhje me vullnetin e saj për vijimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, në kushtet kur Komisioneri Publik kërkoi vazhdimin e gjykimit.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në **“Pallatin e Koncerteve”, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.**

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesues i Trupit Gjykues**  
**Relator i Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtar**

**Ardian Hajdari**  
**Sokol Çomo**  
**Albana Shtylla**  
**Ina Rama**  
**Luan Daci**

Kjo shpallje bëhet në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe në të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTAR**

**ARDIAN HAJDARI**

